

AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË INDO ALBAN CLOTHING STORE Sh.P. K

Kreu I

Themelimi , Emri , Objekti , Kohezgjatja , Selia

Neni 1

Data e themelimit , Emri , forma ligjore dhe Themeluesit

- (1) Sot me 12.12.2022 , ne themeluesit kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **INDO ALBAN CLOTHING STORE**
- (2) Themeluesit e shoqerise jane **5(pese) ortake** :
 1. **Z. Toni KASA**, atesia Gezim, lindur me 02/10/1996 ne Durrës dhe banues ne Galeopsi 03920104; Nd. 2; H. 59; Ap. 33; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, shtetas shqiptar, i identifikuar me pasaportë Nr. BJ1431977 dhe Nr. Personal: J61002067K
 2. **Znj. Ramanpreet KAUR**, atesia Satnam Singh, lindur me 26/06/1998 ne Mand, Punjab dhe banuese ne Village Kotla Heran, Po. Kular Jalandhar, Pin:144702, Punjab, India, shtetase indiane, e identifikuar me pasaportes indiane me Nr. T7430248
 3. **Z. Daljinder SINGH**, atesia Santokh Singh, lindur me 04/03/1992 ne Rahimpur, Punjab dhe banues ne Village Kotla Heran, Po. Kular Jalandhar, Pin:144702, Punjab, India, shtetas indian, i identifikuar me pasaportes indiane me Nr. T7432830
 4. **Z. MANPREET -**, atesia Nanak Chand, lindur me 27/12/1995 ne Dhepur, Punjab dhe banues ne Vill. Dhepur Po. Karhar Jalandhar, Pin:144106, Punjab, India, shtetas indian, i identifikuar me pasaportes indiane me Nr. P7684547
 5. **Z. Jaskaran SINGH**, atesia Gurdev Singh, lindur me 05/03/1998 ne Bham, Punjab dhe banues ne VPO. Bham, Tehsil Garhshankar, Hoshiarpur , Pin : 146103, Punjab, India, shtetas indian, i identifikuar me pasaportes indiane me Nr. S4151445

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2

Emërtimi

2.1 Emërtimi Shoqërisë është **INDO ALBAN CLOTHING STORE**

Neni 3

Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin ligjor shqiptar.

Neni 4 **Baza ligjore**

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut, me aktin e themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5 **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me rregjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)

5.2 **Afati veprimtarisë është i pacaktuar.**

Neni 6 **Selia**

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën : **Galeopsi: Nd . nr. 47 , Vile , Ap.5 , Allias , Njesia Administrative nr .4 , 1010 Tirane .**

6.2 Shoqëria mund të hap degë, filial apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë apo do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7 **Emblema, Vula.**

Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Administratori i shoqërisë.

Neni 8 **Objekti veprimtarisë**

8.1 Objekti veprimtarisë së Shoqërisë është :

Import-eksport te materialeve tekstili , shitje ,blerje me shumicë dhe pakicë , shitblerje on line te tekstileve , qepje te materialeve tekstili , shitblerje e produkteve tekstile, , produkte apo pajisje per tekstilet , mallra ushqimore , erezat indiane , cajra , vaj gatimi , bar restaurant , breakfast , etj .

8.2 Objekti shoqërisë mund të ndryshojë me Vendim të asamblesë së ortakëve.

Kreu II Kapitali

Neni 9 Kapitali

9.1 Kapitali themeltar është 10.000 (dhjete mijë) leke

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme.

9.2 Kapitali përbehet nga 5(pese) kuota me vlerë nominale 2000 (dymijë) leke .

Cdo ortak zoteron një kuota të vetme në shoqëri .

9.3 Toni KASA zoteron 1(një) kuota me pjesëmarrje 24% të kapitalit themeltar , me vlerë kontributi 2400 (dymijë e katërqind) leke .

9.4 RAMANPREET KAUR zoteron 1 (një) kuota me pjesëmarrje 19% të kapitalit themeltar , me vlerë kontributi 1.900 (një mijë e nentëqind) leke.

9.5 DALJINDER SINGH zoteron 1 (një) kuota me pjesëmarrje 19% të kapitalit themeltar , me vlerë kontributi 1.900 (një mijë e nentëqind) leke.

9.6 MANPREET zoteron 1 (një) kuota me pjesëmarrje 19% të kapitalit themeltar , me vlerë kontributi 1.900 (një mijë e nentëqind) leke.

9.7 JASKARAN SINGH zoteron 1 (një) kuota me pjesëmarrje 19% të kapitalit themeltar , me vlerë kontributi 1.900 (një mijë e nentëqind) leke.

9.8 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10 Transferimi pjesëve të kapitalit. Kufizimet.

10.1 Pjesët e kapitali mund të transferohen vetëm me akt noterial të shkruar.

10.2 Vendosja e cdo lloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e asamblesë së ortakëve.

Neni 11 Rritja e kapitalit

11.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me Vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve

11.2 Zmadhimi kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga Ortakë të rinj.

Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të asamblesë së Ortakëve.

Neni 12 **Zvogëlimi Kapitalit**

12.1 Zvogëlimi kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuar nga legjislacioni tregtar shqiptar.

12.2 Propozimi I zvogëlimit do ti paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së Vendimit nga Asambleja e ortakëve. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do ti paraqesin Asamblesë së ortakëve raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti I zvogëlimit do te miratohet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13 **Asambleja e ortakëve.**

13.1 Asambleja e ortakëve perbehet nga

TONI KASA.

RAMANPREET KAUR

DALJINDER SINGH

MANPREET

JASKARAN SINGH

Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë do të merren nga Asambleja e ortakëve të saj.

13.2 Vendimet e asamblesë së ortakëve përfshijnë kryesisht :

- Ndryshimin e selisë dhe emërtimin e shoqërisë
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta.
- Prishjen ose likuidimin e likuidimin e shoqërisë.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë.
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar në qoftë se është e nevojshme.
- Miratimin e bilancit të shoqërisë.
- Ndryshimin e statutit të shoqërisë.
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.
- Dhe cdo lëndë tjetër të përcaktuar nga neni 81, I Ligjit Nr 9901/2008 i ndryshuar .

Neni 14 **Administrimi**

14.1 Administrimi shoqërisë kryhet nga një administrator që caktohen me vendim të asamblesë së ortakëve.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe të drejtojnë punën e përditëshme të shoqërisë në përputhje me udhezimet e asamblesë së ortakëve.

14.3 **Administrator** i shoqërisë është: **Z. Toni Kasa**, shtetas shqiptar, lindur me 02/10/1996 ne Durrës dhe banues ne Galeopsi 03920104; Nd. 2; H. 59; Ap. 33; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, i identifikuar me pasaportë Nr. BJ1431977 dhe Nr. Personal: J61002067K.

14.4 Administratori ka tagra te pakufizuara perfaqesimi dhe është përgjegjës për veprimtarite e mëposhtëme:

- Drejtimin e veprimtarise se përditëshme te shoqërisë;
- Perfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet I nevojshëm për mbarevajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryeje cdo transaksion bankar ne emër të shoqërisë;
- Të ndërmarre çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet I cili konsiderohet I nevojshëm për biznesin në Shqipëri;

14.5 **Mandati i Administratorit do të jetë I vlefshëm për 5 (pese) vjet**, me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me nje vendim të asamblesë së ortakëve.

KREU IV

Viti financiar , Ekspertet

Neni 15

Viti financiar

15.1 Viti financiar I shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1Janari dhe mbaruar me 31 Dhjetor të të çdo viti.

15.2 Si përjashtim viti parë financiar I shoqërisë do të fillojë nga dita e rregjistrimit të shoqërisë në zyrën e tatim – taksave dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.

Neni 16

Bilanci.

Kontabiliteti.

16.1 Bilanci vjetor I shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e ortakëve dhe duhet të përgatitet për tu paraqitur para organeve tatimore deri ne fund te vitit pasaredhes.

16.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime me llogari të veçanta ne monedhe të huaj,duke berë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranoje fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund te lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund te hipotekoj pasuritë e saj te paluajteshme, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 17
Të ardhurat,
Dividenti.

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qellimit të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e Ligjit nr 9901, datë 14.4.2008 “ Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjeset që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar të dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e vitit parë ushtrimor deri në tre vitet ushtrimor vijues.

Neni 18
Likuidimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e kuotëmbajtësve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e kuotave të shoqërisë.

18.2 Me vendimin e asamblesë së ortakëve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që të plotësojnë procedurat e likuidimit.

18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjendjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleje e ortakëve do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirekuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20
Klauzola mbyllëse

Ky statut hartohet në 5(pese) kopje me të njejtë fuqi ligjore.

Ortakët e “ **INDO ALBAN CLOTHING STORE**” Sh.p.k

TONI KASA , RAMANPREET KAUR , DALJINDER SINGH , MANPREET-, JASKARAN SINGH të cilet kanë autorizuar për nënshkrimin e këtij dokumenti përmes Prokurës së posacme Nr.2173 Rep dhe nr. 1524 Kol , date 02.12.2022 dhene perpara Notere Flora MHILLI, Tirane Avokates Elda Jaupllari me nr .license 6105 , anetare e dhomes se Avokateve Tirane , mbajtese e Kartes Identitetit Nr. 035966627 , dhe avokat Eduart Sheko , me nr .license 8013 , anetar I dhomes se Avokateve Tirane, mbajtes i Kartes Identitetit Nr. 037483907

Elda JAUPLLARI

